

V E N D I M
Nr.642, datë 23.9.1996

**PËR SHPËRNDARJEN E BONOVE TË PRIVATIZIMIT TË FAZËS SË DYTË TË
PRIVATIZIMIT MASIV**

Në bazë të ligjit nr.7918, datë 13.4.1995 "Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.1030, datë 23.2.1995 "Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekë privatizimi)" dhe dekretit nr.1049, datë 27.3.1995 "Për disa plotësime në dekretin nr.1030, datë 23.2.1995 "Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit"", Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpërndarja e bonove të privatizimit të fazës së dytë të privatizimit masiv realizohet nga Banka e Kursimeve, sipas listave të përfituesve të këtyre bonove, të dhëna nga Qendra e Informatizimit Financiar.

2. Listat e përfituesve të bonove të privatizimit të fazës së dytë, të ndara sipas rretheve mbi bazë vendbanimi, të plotësohen nga Qendra e Informatizimit Financiar, sipas formularit që i bashkëngjitet këtij vendimi, dhe të dorëzohen në Bankën e Kursimeve brenda datës 15.10.1996. Në këto lista nuk do të përfshihen personat që kanë përdorur vlerën e plotë të bonove të tyre të privatizimit, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.438, datë 14.8.1995 "Për privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore të transformuara në shoqëri tregtare".

3. Banka e Kursimeve të fillojë shpërndarjen e bonove të privatizimit nga data 1.11.1996 dhe të përfundojë brenda datës 15.1.1997. Shpërndarja do të realizohet sipas procedurës së ndjekur për shpërndarjen e bonove të privatizimit të fazës së parë të privatizimit masiv, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.140, datë 22.3.1995 "Për regjistrimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit", dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.201, datë 3.5.1995 "Për miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.140, datë 22.3.1995 "Për regjistrimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit"", si dhe me udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.2, datë 7.4.1995 "Për regjistrimin e përfituesve të bonove të privatizimit".

4. Bonot e privatizimit të personave që kanë vdekur pas datës 1.1.1995 dhe që u takon bono privatizimi sipas kritereve të miratuara, do të merren nga trashëgimtarët e tyre sipas kritereve të përcaktuara në Kodin Civil për trashëgiminë.

5. Pas shpërndarjes së bonove të privatizimit, listat e përfituesve të tyre të plotësuar nga Banka e Kursimeve, të kthehen pranë Qendrës së Informatizimit Financiar për të realizuar kontrollin dhe analizën e procesit.

6. Për rastet e reklamave dhe denoncimeve për dhënien ose tërheqjen e bonove të privatizimit personave të interesuar, vepron komisioni i ngritur sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.140, datë 22.3.1995 "Për regjistrimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit".

7. Bonot e privatizimit, të shpërndara për fazën e parë të privatizimit masiv, do të përdoren edhe për fazën e dytë, e cila përfundon në datën 31.12.1999.

8. Pika 2 dhe pika 4 në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.284, datë 30.4.1996 "Për përcaktimin e fazës së dytë dhe përfundimtare të privatizimit masiv dhe shtypjen e bonove të privatizimit nga Banka e Shqipërisë", shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

SKEMA E KLASIFIKIMIT TË BARNAVE NARKOTIKE DHE LËNDËVE PSIKOTROPE

BARNA NARKOTIKE DHE LËNDË PSIKOTROPE			
Lëndë shumë të rrezikshme		Lëndë të rrezikshme	
Tabela I	Tabela II	Tabela III	
Lëndë që nuk përdoren në mjekësi	Lëndë që përdoren në mjekësi		
(1)Barna narkotike të listës IV të Konventës për Narkotikët, 1961 dhe lëndët psikotrope të Listës I të Konventës për Lëndët Psikotrope, 1971. (2) Eventualisht lëndë të Listave të tjera të Konventave të lartpërmendura (3) Eventualisht lëndë të tjera	(1)Barna narkotike të Listës I¹ dhe II të Konventës për Narkotikët, 1961. (2)Lëndët psikotrope të Listës II të Konventës për Lëndët Psikotrope, 1971 (3)Eventualisht lëndë të listave të tjera të Konventave të lartpërmendura, me përjashtim të lëndëve që përfshihen në tabelën I (shih majtas) (4)Eventualisht lëndë të tjera Grupi A: Lëndë dhe barna që mund të përkruhen për jo më shumë se 7 ditë. Grupi B: Lëndë dhe barna që mund të përkruhen për jo më shumë se 60 ditë	(1)Përgatesat e Listës III të Konventës për Narkotikët, 1961. (2)Lëndët psikotrope të Listës III dhe IV të Konventës për Lëndët Psikotrope, 1971. (3) Eventualisht lëndë të tjera Grupi A: Lëndë dhe barna për të cilat ndalohet ripërsëritja e receitës pa autorizim me shkrim të përshkruesit të receitës. Grupi B: Lëndë dhe barna për të cilat lejohet ripërsëritja e receitës, me përjashtim të rastit kur përshkruesi i receitës mendon ndryshe.	
Kontroll i rreptë i trafikut të paligjshëm	Kontroll i trafikut të paligjshëm	Kontroll i trafikut të paligjshëm	
Ndiqet penalisht mbajtja për konsum vetjak			

1) Me përjashtim të lëndëve të Listës IV.

